



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 93/2017

Prishtinë, më 5.4.2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Rrustem Berisha dhe Enver Hoti, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, zëvendëskryetar i parë, Sasha Milosavljeviq, zëvendëskryetar i dytë, Besim Beqaj dhe Blerim Grainca, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Nebih Shatri- MI, Etleva Malushaj – LVV, Dardan Abazi–INDEP, Fatlinda Gashi – KDI, Sylejman Blaku –Kosova Sot dhe Liridona Ademaj – Kallxo .com.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina, Veton Raci dhe Nurije Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.3.2017;
3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.05/L-132 për Automjete;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.3.2017

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 28.3.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.05/L-132 për Automjete

Muhamet Mustafa, kryetar, tha se komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar raportin me amendamente të Projektligjit nr.05/L-132 për Automjete, dhe nuk kanë dhënë vërejtje, por për ta plotësuar ligjin si Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Legjislacion. Komisioni për Buxhet dhe Financa propozon një amendament me arsyetimin se amendamenti 32 i Komisionit Funkcional, që ka të bëjë me kufizimin e importimit të veturave më të vjetra se dhjetë vjet, ndikon direkt në realizimin e të hyrave të planifikuara në Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, dhe si rrjedhojë propozon që neni që ka të bëjë me kushtet e importit të mjeteve rrugore, respektivisht kufizimin e importimit të veturave deri në dhjetë vjet, të hyjë në fuqi më 1 janar 2018, dhe ka propozuar amendament me tekstin si në vijim:

Amendamenti 1

Në nenin 123, pas paragrafit 2, shtohet paragrafi i ri 3, me tekstin si vijon:

3. Neni me titull “Kushtet e importit të mjeteve rrugore”, hyn në fuqi më 1 janar 2018.

Fatmir Rexhepi, tha e përkrah këtë propozim dhe shtoi se nuk beson që dikush nga deputetët është i interesuar të cenojë planifikimin buxhetor brenda vitit. Mirëpo, për propozimin në fjalë, mendoj që nuk është humbje e madhe buxhetore, edhe te shpjegimi i Komisioni për buxhet ka mbet borxh, që nuk e ka dhënë edhe një pjesë shtesë në aneks me shifra që të shihet sa është pjesëmarrja e këtyre veturave mbi 10 (dhjetë) vjet të vjetra dhe sa është ndikimi i tyre në buxhetin e shtetit.

Komisioni pas debatit e përkrahu amendamentin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Muhamet Mustafa, kryetar, tha se Komisioni për Legjislacion nuk ka parashtruar amendamente por ka rekomanduar që të plotësohet ligji më disa propozime për të cilat propozoj që të përkrahen e më pas i paraqiti rekomandimet e Komisionit për legjislacion si vijon:

1. I rekomandohet Komisionit Funkcional, që amendamenti 27, paragrafi 5, fjalët “paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni” të zëvendësohen me fjalët “e paragrafëve 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni.”
2. I rekomandohet që neni 124 i Projektligjit të hiqet ose të riformulohet në pajtim me Ligjin për Kundërvajtje.
3. I rekomandohet që amendamenti 84, të riformulohet, duke shtuar në fund të fjalisë fjalët “ dhe të gjitha udhëzimet administrative që kanë dalë nga ky ligj.”

Komisioni pas debatit i përkrahu rekomandimet e Komisionit për Legjislacion.

Nebi Shatri, përfaqësuesi i Ministrisë së Infrastrukturës, tha se i ka dy propozime dhe kërkoi nga Komisioni që të ketë mirëkuptim dhe ti aprovojë, sepse mandej do të kemi probleme në zbatim të ligjit. Ai tha të shtohet në dispozita kalimtare, që “neni 34 dhe dispozitat tjera për homologim të hyjnë në fuqi më datë 1 korrik 2019” sepse kemi një kontratë me një operator për shërbime deri më atë datë. Po ashtu, Shatri kërkoi që në dispozita kalimtare të shtohet edhe një paragraf, “ku Neni 89 paragrafi 2 hyn në fuqi 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare” për shkak që si ministri tha, duhet të kemi më shumë kohë të përgatitemi për hyrjen në fuqi të kësaj dispozite.

Komisioni pas debatit miratoi vetëm kërkesën e dytë dhe shtoi një amendament të ri si vijon:

Pas nenit 123, shtohet një nen i ri si vijon:

Dispozita kalimtare

Neni 89.2 hyn në fuqi 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 05/L-132 për Automjete.

2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë, të cilin në emër të Komisionit e paraqet deputeti Fatmir Rexhepi.

4. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në ora 10:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa